

VENDIM

Nr.85, datë 21.1.2009

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES SË NGASTRAVE, TË EKONOMISË PYJORE “LUGINA E FANIT TË MADH”, MIRDITË, QË DO TË PËRDORET NGA “GRUPPO MINERARIO ALBANESE” SHPK, PËR KARRIERA BAZALTESH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2007 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet e ngastrave 94/a, 94/b e 95 të ekonomisë pyjore “Lugina e Fanit të Madh”, Mirditë, që do të përdoren nga “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k., për karriera bazaltesh, me sipërfaqe, gjithsej, 14.4 (katërmëdhjetë pikë katër) ha, të hiqen nga fondi pyjor dhe nga kadastra kombëtare e pyjeve, sipas tabelës nr.1 dhe hartës përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në harta kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të bëjë çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll”, dhe ta regjistrojë në sipërfaqe inproduktive (karrierë bazaltesh), në përputhje me pikën 9 të vendimit nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.
3. Vlera e kësaj sipërfaqeje pyjore të paguhet nga “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k. para hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Llogaritja e tarifave për heqjen nga fondi pyjor të bëhet sipas lidhjes 4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”.

4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, “Gruppo Minerario Albanese” sh.p.k., të pyllëzojë, përpara se të fillojë veprimtarinë, me fondet e veta, 15 (pesëmbëdhjetë) ha, me pyje, në ngastrat e

përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor.

Lloji i drurëve, që do të mbillen, grafiku i mbjelljeve, mënyra e përmirësimit të kullotës caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila do të ndjekë realizimin e mbjelljeve deri në

marrjen në dorëzim me procesverbal, të sipërfaqes së pyllëzuar dhe të përmirësuar, sipas marrëveshjes,

që do të lidhë me kërkuesin.

5. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i

Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela nr.1

NGASTRAT QË KËRKOHEN PËR HEQJE NGA ZËRI KADASTRAL PYLL

Nr. Ekonomia
pyjore

Ngastra,n/ngastra Kërkuar
ha

Zëri
kadastral

Forma e
qeverimit

Funksioni Prona Propozohet

2
EP
Lugina e
Fanit të
Madh
EP
Lugina e
Fanit të
94/a

94/b
5.4

3.9
Pyll

Pyll
Cungishte Prodhues Publike Karrier
bazaltesh

Shkurre Prodhues Publike Karrier
bazaltesh

913

3

Madh
EP
Lugina e
Fanit të

Madh

95

5.1

Pyll

Cungishte Prodhues Publike Karrier
bazaltesh

